



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel 04 2268141; 2268142

Nr. 422/3 Prot.

Tiranë, më 11.07.2017

V E N D I M

Nr. 154, datë 11.07.2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 24, datë 11.03.2016 "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil, në Bashkinë Durrës", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 24, datë 11.03.2016 "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil, në Bashkinë Durrës", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VËREJ SE:

Bazuar në Vendimin nr.87, dt. 04.09.2015, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Durrës", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është realizuar mbikëqyrja në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, pranë këtij institucioni.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr.24, datë 11.03.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil, në Bashkinë Durrës", në të cilin Komisioneri ka vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes tematike, në lidhje me verifikimin e procesit të deklarimit të statusit të punësimit të nëpunësve, të cilët, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar), janë të

punësuar në pozicione të shërbimit civil, në subjektin Bashkia Durrës dhe në Njësitë Administrative në përbërje të saj, i cili është pjesë e këtij vendimi, si dhe të paralajmëroj institucionin për rregullimin e paligjshmërisë sipas detyrave të mëposhtme.

2. *Njësia përgjegjëse, në lidhje me pozicionin e punës “Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun”, të rishikojë vlerësimin e këtij pozicioni në raport me fushën e shërbimit civil, duke marrë parasysh vendin në strukturë dhe detyrat funksionale që ka në kompetencën e tij. Pas kësaj, në zbatim të nenit 67, pika 3 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), si dhe të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014), nëse pozicioni konsiderohet pjesë e shërbimit civil, të vijojë procedura me nxjerrjen e aktit të deklarimit të statusit të punësimit si më poshtë:*

- *për nëpunësen *****, në kategorinë “nëpunëse civile”, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun”, e cila, aktualisht, është e punësuar në këtë pozicion pune;*
- *për nëpunësen *****, në kategorinë “nëpunëse civile në periudhë prove”, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun”. Në këtë rast, njësia përgjegjëse, duhet të marrë masat për të zbatuar të gjitha detyrimet ligjore që parashikon ligji për punonjësit në periudhë prove, duke përfshirë përfundimin e trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA); përcaktimin e një punonjësi më të vjetër për t`u kujdesur, si dhe vlerësimin e punës nga eprori dhe pas kësaj, duhet të shprehet për konfirmimin si nëpunës civil ose jo të punonjësit në periudhë prove.*

3. *Njësia përgjegjëse, të plotësojë aktet e konfirmimit si nëpunës civil, me vlerësimin e rezultateve individuale në punë, shoqëruar me mendimin me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, për nëpunësit civilë në periudhë prove, për të cilët, procedura e vendimmarrjes në fund të periudhës së provës, është kryer vetëm mbi bazën e rezultateve të testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA). Ky qëndrim vjen në kundërshtim me nenin 24 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) dhe me pikën 7, Kreu V “Periudha e provës”, të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese” (i shfuqizuar). Në rastin konkret, njësia përgjegjëse duhet të veprojë në këtë mënyrë:*

- *Të kryejë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së provës, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore.*
- *Të administrohet në dosjen e personelit, së bashku me aktin e vlerësimit të punës, mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, udhëzimet e të cilit ka ndjekur nëpunësi gjatë periudhës së provës.*

- Të administrohet rezultati i testimi në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA), si dhe çertifikata e lëshuar në këtë rast prej këtij institucioni.
- Të nxjerrë vendimin e arsyetuar në përfundim të periudhës së provës, për punonjësit si më poshtë:
 - *****, në pozicionin e punës “Specialiste juriste”;
 - *****, në pozicionin e punës “Shefe e Sektorit të të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat”;
 - *****, në pozicionin e punës “Specialiste në Sektorin e të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat”;
 - *****, në pozicionin e punës “Inspektore në Sektorin e Kontrollit të Taksave dhe Tarifave Vendore”;
 - *****, në pozicionin e punës “Drejtor i Drejtorisë Ligjore”;
 - *****, në pozicionin e punës “Specialiste në Sektorin e Ndhmës Ekonomike dhe Invaliditetit”;
 - *****, në pozicionin e punës “Administrator në Qendrën Administrative nr.6”.

4. Njësia përgjegjëse, të fillojë procedurën për përfundimin e marrëdhënies së punësimit për punonjësit, të cilët kanë nivelin e mesëm të edukimit arsimor, e për këtë shkak, nuk plotësojnë kriterin e nivelit të arsimit të lartë që duhet të ketë nëpunësi në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil ku ata janë emëruar, e parashikuar në pikën 6 të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” (ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014), si më poshtë:

- Përfundimi i marrëdhënies së punësimit për punonjësin *****, emëruar me aktin nr. 5318, datë 04.11.2013, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Informatizimit dhe Teknologjisë së Shërbimit”, Bashkia Durrës.
- Përfundimi i marrëdhënies së punësimit për punonjësin *****, emëruar me aktin nr. 447, datë 15.02.2014, në pozicionin “Specialiste në Sektorin e Kadastrës Urbane”, Bashkia Durrës.
- Përfundimi i marrëdhënies së punësimit për punonjësin *****, emëruar me aktin nr. 2504, datë 01.06.2009, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Njesisë së Legalizimit”, Bashkia Durrës.
- Përfundimi i marrëdhënies së punësimit për punonjësin *****, emëruar me aktin nr. 794, datë 10.02.2014, në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Kontrollit të Taksave dhe Tarifave Vendore”, Bashkia Durrës.
- Përfundimi i marrëdhënies së punësimit për punonjësin *****, emëruar me aktin nr. 2561, datë 06.03.2003, në pozicionin “Inspektor në Qendrën Administrative nr.5”, Bashkia Durrës.
- Përfundimi i marrëdhënies së punësimit për punonjësen *****, emëruar në pozicionin “Arkiviste”, Njësia Administrative Sukth.
- Përfundimi i marrëdhënies së punësimit për punonjësin *****, emëruar në pozicionin “Inspektor në Sektorin P.K.ZH.T”, Njësia Administrative Sukth.

- Përfundimi i marrëdhënies së punësimit për punonjës të ******, emëruar në pozicionin “Inspektor në Sektorin Tatim Taksa”, Njësia Administrative Sukth.
- Përfundimi i marrëdhënies së punësimit për punonjës të ******, emëruar në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës”, Njësia Administrative Sukth.
- Përfundimi i marrëdhënies së punësimit për punonjës të ******, emëruar në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës”, Njësia Administrative Sukth.
- Përfundimi i marrëdhënies së punësimit për punonjës të ******, emëruar në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Shërbimeve”, Njësia Administrative Sukth.
- Përfundimi i marrëdhënies së punësimit për punonjës të ******, emëruar në pozicionin “Specialist Buxheti”, Njësia Administrative Ishëm.
- Përfundimi i marrëdhënies së punësimit për punonjës të ******, emëruar në pozicionin “Inspektor i Mbrojtjes së Pyjeve”, Njësia Administrative Ishëm.
- Përfundimi i marrëdhënies së punësimit për punonjës të ******, emëruar në pozicionin “Inspektor i Mbrojtjes së Pyjeve”, Njësia Administrative Ishëm.
- Përfundimi i marrëdhënies së punësimit për punonjës të ******, emëruar në pozicionin “Inspektor Veteriner”, Njësia Administrative Ishëm.
- Përfundimi i marrëdhënies së punësimit për punonjës të ******, emëruar në pozicionin “Inspektor i tatimeve në terren”, Njësia Administrative Ishëm.
- Përfundimi i marrëdhënies së punësimit për punonjës të ******, emëruar në pozicionin “Inspektor page”, Njësia Administrative Ishëm.
- Përfundimi i marrëdhënies së punësimit për punonjës të ******, emëruar në pozicionin “Specialist i ndihmës ekonomike”, Njësia Administrative Rrashbull.

Rekomandohet njësia përgjegjëse që, vendet e punës si më sipër, t’i shpallë vende të lira, për t’u plotësuar sipas procedurave të përcaktuara nga ligji dhe në koherencë me implementimin e reformës territoriale, materializuar në strukturën e institucionit.

5. Njësia përgjegjëse duhet të revokojë aktin nr. 446/1, datë 14.04.2015, me të cilin punonjësi ******, është konfirmuar “nëpunës civil” në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës”, në Njësinë Administrative Sukth, pasi ky punonjës, nuk ka kryer trajnimin e detyrueshëm në Shkollën e Administratës Publike (ASPA). Në zbatim të përcaktimeve të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, duhet të shtyhet periudha e provës për nëpunësin e mësipërm dhe konfirmimi i tij, duhet të bëhet pasi të përfundohet me sukses trajnimi i detyrueshëm në Shkollën e Administratës Publike (ASPA).
6. Njësia përgjegjëse, për punonjësit e punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), në Bashkinë Manëz, Komunën Katund i Ri, Komunën Rrashbull, aktualisht Njësia Administrative të Bashkisë Durrës, për të cilat, gjatë procesit të mbikëqyrjes, nuk u mundësua verifikimi për shkak të mungesës së dokumentacionit në dosjen e personelit për punonjësit e tyre, të veprojë si më poshtë:

- *Të plotësohen dosjet individuale të nëpunësve me të gjitha të dhënat në zbatim të nenit 17 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) dhe të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.*
 - *Të fillojë procesi i verifikimit në lidhje me plotësimin e kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar).*
 - *Pas përfundimit të verifikimit, të deklarohet statusi i punësimit për secilin prej punonjësve të punësuar në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar).*
- 7.** *Njësia përgjegjëse, në zbatim të nenit 67, pika 3, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), të nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të punësimit në kategorinë “nëpunës civilë”, për punonjësit e Komunës Ishëm, aktualisht njësi administrative, si më poshtë:*
- ****** në pozicionin e punës “Specialist arkive”;*
 - ****** në pozicionin e punës “Përgjegjës i Zyrës së Tatimeve”.*
- 8.** *Njësia përgjegjëse të verifikojë plotësimin e kriterit të nivelit arsimor për punonjësen *****; e emëruar dhe e konfirmuar nëpunëse civile në periudhë prove, në pozicionin “Specialiste protokolli”, pranë Komunës Ishëm, aktualisht njësi administrative. Në përfundim të verifikimit, të veprohet si më poshtë:*
- *Në rast se kjo punonjëse nuk e plotëson kriterin e nivelit arsimor, për shkak të edukimit arsimor të mesëm, të revokohet akti nr. 583/2, datë 14.05.2014, me anë të të cilit ajo është deklaruar nëpunëse civile në periudhë prove, si dhe të revokohet akti nr. 1/3, datë 03.01.2014, me anë të të cilit është emëruar në pozicionin “Specialiste protokolli”.*
 - *Në të kundërt, të vazhdojë procedura e vendimmarrjes në përfundim të periudhës së provës, duke u kujdesur për të zbatuar të gjitha kërkesat që parashikon ligji për punonjësit në periudhë prove, duke përfshirë përfundimin e trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASP), përcaktimin e një punonjësi më të vjetër për t’u kujdesur, si dhe vlerësimin e punës nga eprori dhe pas kësaj të shprehet për konfirmimin ose jo në këtë pozicion.*
- 9.** *Njësia përgjegjëse, në zbatim të nenit 128 të Kodit të Procedurave Administrative, “Ndryshimi dhe zëvendësimi i akteve administrative”, duhet të ndryshojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, duke i shtuar faktin që nëpunësi duhet të konsiderohet nëpunës civil në periudhë prove, si më poshtë:*
- *Ndryshimin e aktit administrativ nr. 583/1, datë 14.05.2014, për deklarimin e statusit të punësimit për nëpunësin *****; në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Financës”, pranë Njesisë Administrative Ishëm.*

Në këtë rast, njësia përgjegjëse duhet të marrë masat për të zbatuar të gjitha detyrimet ligjore që parashikon ligji për punonjësit në periudhë prove, duke përfshirë përfundimin e trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA); përcaktimin e një punonjësi më të vjetër për t'u kujdesur, si dhe vlerësimin e punës nga eprori dhe pas kësaj duhet të shprehet për konfirmimin, ose jo të nëpunësit civil në periudhë prove.

10. *Njësia përgjegjëse, të verifikojë mënyrën e përfundimit të marrëdhënies së punës, duke specifikuar nëse kjo marrëdhënie ka përfunduar për shkak të mosplotësimit të kriterit arsimor, apo për arsye të tjera të parashikuara në ligj, për punonjësit e Njesisë Administrative Ishëm, pasi, nga mungesa e dokumentacionit, nuk u bë i mundur verifikimi nga grupi i mbikëqyrjes, si më poshtë:*

- ******, emëruar në pozicionin “Specialist pagash”;*
- ******, emëruar në pozicionin “Specialist i urbanistikës”;*
- ******, emëruar në pozicionin “Inspektor tatimor”;*
- ******, emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Shërbimeve Publike”;*
- ******, emëruar në pozicionin “Inspektor shërbimesh”;*
- ******, emëruar në pozicionin “Inspektor shërbimesh”.*

Pas përfundimit të verifikimit, njësia përgjegjëse duhet të shprehet në lidhje me ligjshmërinë e akteve administrative të përfundimit të marrëdhënies së punës.

11. *Të administrohen në dosjen e personelit, aktet e emërimit për punonjësit si më poshtë:*

- ******, emëruar në pozicionin “Specialist i urbanistikës” pranë Njesisë Administrative Ishëm;*
- ******, emëruar në pozicionin “Inspektor shërbimesh” pranë Njesisë Administrative Ishëm;*
- ******, emëruar në pozicionin “Specialist për transportet” pranë Njesisë Administrative Rrashbull.*

Nëse këto akte kanë dalë në kundërshtim me ligjin (pasi mungesa e akteve nuk e mundësoi verifikimin nga grupi i mbikëqyrjes), për shkak të emërimit me kontratë pune pas hyrjes në fuqi të ligjit, ato duhet të revokohen, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune në pozicione që janë pjesë e shërbimit civil, e cila lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), sipas nenit 22 e vijues të këtij ligji, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt ligjore nëpërmjet konkurrimit të hapur, apo duke respektuar sistemin e karrierës, nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë. Në të kundërt, duhet të përfundojë procesi i deklaramit të statusit të punësimit.

12. *Njësia përgjegjëse të fillojë procedurën për revokimin e akteve administrative, të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), që parashikojnë plotësimin e një pozicioni të lirë pune detyrimisht nëpërmjet një procedure të rregullt konkurrimi, si më poshtë:*

- *Revokimin e aktit administrativ nr. 9, datë 02.04.2014, për emërimin e nëpunëses ***** në pozicionin “Specialist për turizmin”, pranë Njesisë Administrative Ishëm.*
- *Revokimin e aktit administrativ nr. 10, datë 02.04.2014, për emërimin e nëpunësit ***** në pozicionin “Inspektor i Mbrojtjes së Pyjeve”, pranë Njesisë Administrative Ishëm.*
- *Revokimin e aktit administrativ nr.39, datë 01.09.2014, për emërimin e nëpunësit ***** në pozicionin “Specialist për energjinë”, pranë Njesisë Administrative Rrashbull.*
- *Revokimin e aktit administrativ nr.29, datë 01.07.2014, për emërimin e nëpunësit ***** në pozicionin “Inspektor veteriner”, pranë Njesisë Administrative Rrashbull.*
- *Revokimin e aktit administrativ nr. 9, datë 01.04.2014, për emërimin e nëpunëses ***** në pozicionin “Arkiviste”, pranë Njesisë Administrative Rrashbull.*
- *Revokimin e aktit administrativ nr. 10, datë 11.04.2014, për emërimin e nëpunëses ***** në pozicionin “Specialist për mbrojtjen e fëmijëve”, pranë Njesisë Administrative Rrashbull.*

Rekomandohet njësia përgjegjëse që, vendet e punës si më sipër, t’i shpallë vende të lira, për t’u plotësuar sipas procedurave të përcaktuara nga ligji dhe në koherencë me implementimin e reformës territoriale, pasqyruar në strukturën e institucionit.

- 13.** *Njësia përgjegjëse, në kushtet e riorganizimit të strukturës dhe organikës së njesisë administrative, me qëllim që të respektohen kërkesat e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar) dhe të akteve nënligjore, të bëjë klasifikimin e saktë të pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e çdo pozicioni, si dhe të njehsojë pozicionet specifike me ato të përcaktuara në nenin 19 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar). Këto pozicione, të evidentohen në çdo rast, në strukturën dhe organikën përkatëse, ku të jetë shënuar edhe kategoria e pagës për çdo pozicion pune.*
- 14.** *Njësia përgjegjëse të fillojë procedurën për revokimin e akteve administrative, të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, ”Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), në lidhje me procesin e ristrukturimit të kryer pranë Njesisë Administrative Sukth, si më poshtë:*
- *Revokimin e aktit administrativ nr. 6848, datë 18.09.2015, për lirimin nga shërbimi civil të nëpunëses ***** dhe kthimin e saj në pozicionin e mëparshëm të punës “Inspektor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, pasi nuk ndodhemi në kushtet e ristrukturimit.*
 - *Revokimin e aktit administrativ nr. 7320, datë 01.10.2015, për emërimin e punonjësës ***** në pozicionin “Inspektor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, pasi është emëruar pa konkurrim, në kundërshtim me ligjin.*

15. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60 ditë** nga marrja dijani për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e materializuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve në vendimin e mësipërm, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në nenin 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe në Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, vendosi kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim, për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në Vendimin nr.24, datë 11.03.2016.

Për këtë arsye, me Vendimin nr.64, datë 31.05.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u ngrit grupi i punës, i cili u paraqit në subjektin Bashkia Durrës, në datën 08.06.2016 dhe i kërkoi personit përgjegjës, nëpunëses *****, dosjet e personelit dhe dokumentacionin shkresor të dalë në zbatim të rekomandimeve të vendimit paralajmërues të Komisionerit.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore, të vëna në dispozicion, rezultoi se:

- Njësia përgjegjëse, në zbatim të pikës 2 të vendimit, pasi ka vlerësuar pozicionet e punës “Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun” në raport me legjislacionin e shërbimit civil, e konkretisht, nenin 2 dhe nenin 4, pika 1, gërma c të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka vendosur që këto pozicione pune, që mbajnë punonjëset ***** dhe ***** të mos përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil. Njësia përgjegjëse ka arritur në këtë përfundim nisur nga detyrat që kryejnë këto punonjëse sipas përshkrimit të punës për këtë pozicion. Ato nuk ushtrojnë funksione publike, por veprimtari administrative shërbimi.
- Në lidhje me plotësimin e akteve të konfirmimit si nëpunës civilë për nëpunësit civilë në periudhë prove, për të cilët, procedura e vendimmarrjes në fund të periudhës së provës është kryer vetëm mbi bazën e rezultateve të testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike, njësia përgjegjëse, në zbatim të rekomandimit të pikës 3 të vendimit të Komisionerit, ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë në përfundim të periudhës së provës (akt i cili mungonte), sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore. Është administruar në dosjen e personelit rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA), si dhe çertifikata e lëshuar prej këtij institucioni dhe janë plotësuar aktet e konfirmimit të shtatë nëpunësve civilë të cituar në pikën 3 të vendimit të Komisionerit sipas përcaktimeve të nenit 24 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”. Këto akte janë të administruara në dosjen e verifikimit të zbatimit të vendimit.

- Në zbatim të pikës 4 të vendimit, njësia përgjegjëse ka përfunduar marrëdhënien e punësimit, për shkak të mosplotësimit të kriterit arsimor sipas përcaktimeve të pikës 6 të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014), për punonjësit:
1. *****, së cilës me aktin administrativ nr.1311 Prot., dt.29.02.2016, “Zgjidhja e kontratës së punës”, i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit përpara daljes së vendimit të Komisionerit, pas njohjes me konkluzionet e projektraportit.
 2. *****, me detyrë “Specialist në Sektorin e Informatizimit dhe Teknologjisë së Shërbimit”, rezultoi se ishte me arsim të lartë, fakt i cili nuk është evidentuar gjatë periudhës së mbikëqyrjes, sepse ky dokument nuk ndodhej në dosje. Pavarësisht faktit që nëpunësi kishte filluar punë para hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, ai është emëruar në pozicionin e mësipërm me aktin administrativ nr.6479, dt.09.09.2015, pas përfundimit të procedurës së konkurrimit sipas përcaktimeve të nenit 22 të ligjit të cituar më sipër.
 3. *****, së cilës, njësia përgjegjëse, me aktin administrativ nr.4024 Prot., dt.23.05.2016, “Zgjidhja e kontratës së punës”, i ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit.
 4. *****, së cilit, njësia përgjegjëse, me aktin administrativ nr.4022 Prot., dt.23.05.2016, “Zgjidhja e kontratës së punës”, i ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit.
 5. *****, së cilit, njësia përgjegjëse, me aktin administrativ nr.4023 Prot., dt.23.05.2016, “Zgjidhja e kontratës së punës”, i ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit.
 6. *****, së cilës, njësia përgjegjëse, me aktin administrativ nr.6912 Prot., dt.21.09.2015, “Njoftim i përfundimit të marrëdhënies së punës”, i ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit.
 7. *****, së cilit, njësia përgjegjëse, me aktin administrativ nr.7075 Prot., dt.25.09.2015, “Njoftim i përfundimit të marrëdhënies së punës”, i ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit.
 8. *****, së cilit, njësia përgjegjëse, me aktin administrativ nr.7076 Prot., dt.25.09.2015, “Njoftim i përfundimit të marrëdhënies së punës”, i ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit.
 9. *****, së cilit, njësia përgjegjëse, me aktin administrativ nr.6918 Prot., dt.21.09.2015, “Njoftim i përfundimit të marrëdhënies së punës”, i ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit.
 10. *****, me detyrë “Inspektor në Sektorin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës”, rezultoi se kishte filluar punë para hyrjes në fuqi të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe ishte me arsim të lartë, fakt i cili nuk është evidentuar gjatë periudhës së mbikëqyrjes, sepse ky dokument nuk ndodhej në dosje.
 11. *****, me aktin administrativ nr.10025, dt.24.12.2015, është emëruar “Mirëmbajtës”, në Ndërmarrjen e Shërbimeve Komunale Durrës, pozicion që nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.

12. *****, së cilit, njësia përgjegjëse, me aktin administrativ nr.6778 Prot., dt.17.09.2015, “*Njoftim i përfundimit të marrëdhënies së punës*”, i ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit.
 13. *****, së cilit, njësia përgjegjëse, me aktin administrativ nr.6776 Prot., dt.17.09.2015 “*Njoftim i përfundimit të marrëdhënies së punës*”, i ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit.
 14. *****, së cilit, njësia përgjegjëse, me aktin administrativ nr.6775 Prot., dt.17.09.2015, “*Njoftim i përfundimit të marrëdhënies së punës*”, i ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit.
 15. *****, të cilit me Vendimin nr.62, dt.02.11.2015 “*Për largim nga detyra*”, të titullarit të institucionit i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit.
 16. *****, së cilit, njësia përgjegjëse, me aktin administrativ nr.6882 Prot., dt.21.09.2015, “*Njoftim i përfundimit të marrëdhënies së punës*”, i ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit.
 17. *****, së cilit, njësia përgjegjëse, me aktin administrativ nr.6777 Prot., dt.17.09.2015, “*Njoftim i përfundimit të marrëdhënies së punës*”, i ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit.
 18. *****, së cilës, njësia përgjegjëse, me aktin administrativ nr.67845 Prot., dt.15.10.2015 “*Njoftim i përfundimit të marrëdhënies së punës*”, i ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit.
- Në lidhje me revokimin e aktit të konfirmimit si nëpunës civil të punonjësit ***** dhe shtyrjen e periudhës së provës deri në përfundimin me sukses të trajnimit të detyrueshëm në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, rezultoi se, bazuar në ligjin nr. 115/2014, “*Për ndarjen administrative territoriale të njërive të qeverisjes vendore*”, Këshilli Bashkiak Durrës, me vendimin nr.281, dt.09.09.2015, ka miratuar numrin e përgjithshëm të punonjësve. Në vijim të këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë Urdhrin nr.221, dt.14.09.2015, për fillimin e procedurave ligjore të përfundimit të marrëdhënieve të punësimit për punonjësitet, të cilëve iu është shkurtuar vendi i punës. Në zbatim të këtij Urdhri, njësia përgjegjëse, me aktin administrativ nr.6839, dt.18.09.2015, “*Njoftim i përfundimit të marrëdhënies së punës*”, ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit me punonjësin ***** për shkak të ristrukturimit.
- Në zbatim të pikës 6 të vendimit, për punonjësitet e ish Bashkisë Manëz, ish Komunës Katund i Ri dhe ish Komunës Rrashbull (aktualisht njësi administrative të Bashkisë Durrës), të cilët, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, u gjendën në pozicione të shërbimit civil, por për shkak të mungesës së dokumentacionit në dosjen e personelit ishte e pamundur kryerja e verifikimit, njësia përgjegjëse e Bashkisë Durrës, pasi ka plotësuar dosjet individuale me të gjithë të dhënat në zbatim të nenit 17 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar) dhe të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”, ka kryer verifikimin në lidhje me plotësimin e kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit dhe, në përfundim, ka nxjerrë aktet e deklaramit të statusit të punësimit sipas përcaktimeve të këtij neni.

- Në lidhje me nxjerrjen e akteve të deklarimit të statusit të punësimit në kategorinë “*nëpunës civilë*”, për punonjësit e ish Komunës Ishëm (aktualisht njësi administrative e Bashkisë Durrës), *****, në pozicionin e punës “*Specialist arkive*” dhe *****, në pozicionin e punës “*Përgjegjës i Zyrës së Tatimeve*”, rezultoi se njësia përgjegjëse, me aktin nr.75, dt.16.03.2015, ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit të ***** me Ish Komunën Ishëm para se të miratohet Vendimi i Këshillit Bashkiak Durrës, nr.281, dt. 09.09.2015, “*Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Durrës*”, dalë në bazë e për zbatim të ligjit nr. 115/2014 “*Për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore*” (Ky akt është nxjerrë përpara fillimit të mbikëqyrjes nga Komisioneri dhe nuk i është vënë në dispozicion grupit të mbikëqyrjes. Në momentin e verifikimit të vendimit të Komisionerit rezultoi se ky akt nuk ndodhej në dosjen individuale të punonjësës). Në këtë rast, njësia përgjegjëse, ka vepruar në kundërshtim me ligjin, duke i mohuar punonjësës statusin e nëpunësit civil dhe gjithë të drejtat që rrjedhin prej tij. Duke qenë se nga ana e punonjësës nuk ka pasur ankimim të këtij akti administrativ apo kërkim për njohjen e të drejtave të mohuara, arrihet në përfundimin se punonjësja, me veprime konkludente, ka pranuar në heshtje humbjen e tyre. Nga ana tjetër, njësia përgjegjëse duhet të bëjë kujdes që në vazhdimësi të zbatojë me korrektësi përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Ndërsa në rastin e nëpunësit ***** me detyrë “*Përgjegjës i Zyrës së Tatimeve*” njësia përgjegjëse, meqenëse këtij nëpunësi i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit për arsye të shkurtimit të pozicionit të punës, pas miratimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës, nr.281, dt. 09.09.2015, “*Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Durrës*”, e ka konsideruar nëpunës civil dhe i ka njohur dëmshpërblimin financiar sipas parashikimeve të pikës 7 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

- Në zbatim të pikës 8 të Vendimit, njësia përgjegjëse, pasi ka verifikuar nivelin arsimor të punonjësës ***** me detyrë “*Specialiste Arkiv-Protokoll*”, në Njësinë Administrative Ishëm, ka nxjerrë Vendimin nr.24, dt.29.02.2016, “*Për lirim nga detyra*”, për këtë punonjëse, për arsye të mospërputhjes së arsimit me pozicionin e punës, sipas përcaktimit të pikës 6 të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014).*
- Në lidhje me rekomandimin e pikës 9 të Vendimit, për ndryshimin e aktit administrativ për deklarimin e statusit të punësimit për punonjësën ***** me detyrë “*Përgjegjës i Zyrës së Financës*”, nga “*nëpunës civil*” në “*nëpunës civil në periudhë prove*”, duke zbatuar të gjitha detyrimet që parashikon ligji për punonjësit në periudhë prove, rezulton se këtij punonjësi i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit me aktin nr.6879, dt.21.09.2015, për arsye të shkurtimit të pozicionit të punës, pas miratimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës, nr.281, dt. 09.09.2015, “*Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Durrës*”. Njësia përgjegjëse e ka konsideruar nëpunës civil dhe i ka njohur dëmshpërblimin financiar sipas parashikimeve të pikës 7 të nenit 50 të ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në mënyrë të paligjshme,

sepse ky punonjës nuk mund të konsiderohej nëpunës civil, pa përmbushur më parë të gjitha detyrimet e përcaktuara në ligj dhe në pikën 9 të dispozitivit të Vendimit të Komisionerit.

➤ Në zbatim të pikës 10 të Vendimit, njësia përgjegjëse pasi ka verifikuar mënyrën e përfundimit të marrëdhënieve të punës të punonjësve të Njesisë Administrative Ishëm, verifikim, i cili ishte i pamundur të kryhej nga ana e grupit të mbikëqyrjes për mungesë dokumentacioni, ka përcaktuar shkakun e ndërprerjes të marrëdhënieve të punës për punonjësit e poshtëshënuar:

1. Për punonjës të ***** , i dtl.28.02.1948, me detyrë “*Specialist pagash*”, shkak për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, me aktin nr.13, dt.13.02.2015, është bërë plotësimi i moshës për pensionin e plotë të pleqërisë, sipas përcaktimeve të nenit 65, pika 1, gërma c të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
2. Për punonjës të ***** me detyrë “*Specialist i urbanistikës*”, në Njësinë Administrative Ishëm, shkak i ndërprerjes së marrëdhënies së punës me aktin nr.53, dt.10.02.2015 është bërë mospërputhja e arsimit (*arsimi i mesëm*) me pozicionin e punës, sipas përcaktimit të pikës 6 të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014).*
3. Për punonjës të ***** me detyrë “*Inspektor tatimor*”, në Njësinë Administrative Ishëm, shkak i ndërprerjes së marrëdhënies së punës me aktin nr.51, dt.10.02.2015 është bërë zgjedhja e tij si anëtar i Këshillit Komunal, e në kuptim të nenit 2, gërma a të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, punonjësi nuk mund të kryejë funksione të shërbimit civil.
4. Për punonjës të ***** me detyrë “*Specialist finance*” në Njësinë Administrative Ishëm, shkak për ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit me aktin administrativ nr.23, dt.29.02.2016, “*Për lirim nga detyra*”, është bërë fillimi i marrëdhënies së punës në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
5. Për punonjës të ***** me detyrë “*Inspektor shërbimesh*”, në Njësinë Administrative Ishëm, shkak i ndërprerjes së marrëdhënies së punës me aktin e datës 22.04.2015, është bërë mospërputhja e arsimit (*arsimi i mesëm*) me pozicionin e punës, sipas përcaktimit të pikës 6 të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014).*
6. Për nëpunësin ***** , me detyrë “*Inspektor shërbimesh*”, shkak për ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit me aktin administrativ nr.6769, dt.17.09.2015, është bërë shkurtimi i pozicionit të punës, pas miratimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës, nr.281, dt. 09.09.2015, “*Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Durrës*”. Njësia përgjegjëse e ka konsideruar nëpunës civil dhe i ka njohur dëmshpërblimin financiar sipas parashikimeve të pikës 7 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

➤ Në lidhje me administrimin në dosjen e personelit të akteve të emërimit të *****, ***** dhe *****, përcaktuar në pikën 11 të Vendimit, u konstatua se njësia përgjegjëse ka administruar në dosje aktet për ndërprerjen e marrëdhënies së punës punonjësve dhe jo aktet e emërimit. Moszbatimi i rekomandimit të Komisionerit ka ardhur për shkak se në dosjet e punonjësve nuk ka pasur akte emërimi (*fakt i evidentuar dhe në tabelat që ka përpunuar grupi i mbikëqyrjes*) dhe të dhënat me të cilat është disponuar nga njësia përgjegjëse për ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit janë marrë nga regjistri i personelit i ish-Komunës Ishëm. Konkretisht, në përfundim të verifikimit, rezultoi sa më poshtë vijon:

1. Për nëpunësin *****, me detyrë “*Specialist i urbanistikës*”, shkak për ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit me aktin administrativ nr. 6949, dt.21.09.2015, është bërë shkurtimi i pozicionit të punës (*Ristrukturim*), pas miratimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës, nr.281, dt. 9.09.2015, “*Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Durrës*”. Nga përmbajtja e aktit administrativ të mësipërm rezulton se referenca ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit është ligji nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. Me aktin administrativ nr.583/2, dt.14.05.2014, punonjësi ***** është deklaruar nëpunës civil në periudhë prove në detyrën “*Specialist i urbanistikës*”, në ish Komunën Ishëm dhe për këtë shkak i është njohur dëmshpërblimi financiar sipas parashikimeve të pikës 7 të nenit 50 të ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
2. Me aktin administrativ nr.10025, dt.24.12.2015, punonjësi ***** është emëruar “*Mirëmbajtës*”, në Ndërrmarrjen e Shërbimeve Komunale Durrës, pozicion që nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.
3. Me aktin administrativ nr.10024, dt.24.12.2015, punonjësi ***** është emëruar “*Mirëmbajtës*”, në Ndërrmarrjen e Shërbimeve Komunale Durrës, pozicion që nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.

➤ Në pikën 12 të Vendimit, njësisë përgjegjëse i ishte lënë detyrë që të fillonte procedurën për revokimin e akteve administrative të dala në kundërshtim me ligjin, pa respektuar kërkesat për plotësimin e një pozicioni të lirë pune, përmes një procedure të rregullt konkurrimi. Gjatë procesit të verifikimit rezultoi se njësia përgjegjëse për një pjesë të punonjësve ka nxjerrë aktet e ndërprerjes së marrëdhënies së punësimit për punonjësit e cituar më poshtë, përpara fillimit të mbikëqyrjes të ushtruar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil e konkretisht:

1. Për nëpunësen *****, me detyrë “*Specialiste për turizmin*”, shkak për ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit me aktin administrativ nr. 6949, dt.21.09.2015, është bërë shkurtimi i pozicionit të punës, pas miratimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës, nr.281, dt. 09.09.2015, “*Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Durrës*”. Njësia përgjegjëse, në aktin e sipërcituar, e ka konsideruar këtë punonjëse nëpunëse civile dhe i ka njohur dëmshpërblimin financiar sipas parashikimeve të pikës 7 të nenit 50 të ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. Ky veprim i njësisë përgjegjëse bie në kundërshtim me ligjin, pasi kjo punonjëse ishte marrë në punë në kundërshtim me

- ligjin. Për këtë arsye, kjo punonjëse nuk mund të konsiderohej nëpunëse civile e për rrjedhojë nuk mund të përfitonte nga pika 7 e nenit 50 të ligjit. Në analizë të sa më sipër, njësia përgjegjëse duhet të bëjë kujdes që në të ardhmen të zbatohet me korrektësi ligjin.
2. Për nëpunësin *****, me detyrë “*Inspektor i Mbrotjes së Pyjeve*”, shkak për ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit me aktin administrativ nr. 6774, dt.17.09.2015, është bërë shkurtimi i pozicionit të punës, pas miratimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës, nr.281, dt. 09.09.2015, “*Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Durrës*”. Ky punonjës është emëruar me aktin nr.10025, dt.24.14.2015 në pozicionin “*Mirëmbajtës*”, në Ndërrmarrjen e Shërbimeve Komunale Durrës, pozicion që nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.
 3. Për nëpunësin *****, me detyrë “*Specialist për energjinë*”, shkak për ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit me aktin administrativ nr. 7865, dt.15.10.2015, është bërë shkurtimi i pozicionit të punës, pas miratimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës, nr.281, dt. 09.09.2015, “*Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Durrës*”, duke e trajtuar këtë punonjës në bazë të parashikimeve të Kodit të Punës.
 4. Për nëpunësen *****, me detyrë “*Arkiviste*”, shkak për ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit me aktin administrativ nr. 6949, dt.21.09.2015 është bërë shkurtimi i pozicionit të punës, pas miratimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës, nr.281, dt. 09.09.2015, “*Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Durrës*”, duke e trajtuar këtë punonjëse në bazë të parashikimeve të Kodit të Punës.

Në dy raste, njësia përgjegjëse, ka vendosur përfundimin e marrëdhënies së punësimit, në përputhje me rekomandimin e Komisionerit, për shkak të paligjshmërisë së procedurës së emërimit të punonjësve. Konkretisht:

1. Punonjësi *****, me detyrë “*Inspektor veteriner*”, është larguar nga detyra me aktin administrativ nr. 4020, dt.23.05.2016.
 2. Punonjësja *****, me detyrë “*Specialiste për Mbrojtjen e Fëmijëve*”, është larguar nga detyra me aktin administrativ nr. 4021, dt.23.05.2016.
- Në zbatim të pikës 13 të Vendimit, njësia përgjegjëse në kushtet e riorganizimit të strukturës dhe organikës së Bashkisë Durrës, pas miratimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës, nr.281, dt. 09.09.2015, “*Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Durrës*”, në respektim të kërkesave të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka bërë klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil dhe kategoritë e pagës në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e çdo pozicioni.
 - Në lidhje me revokimin e akteve administrative të dala në kundërshtim me ligjin në kuadër të procesit të ristrukturimit të kryer pranë Njesisë Administrative Sukth, përcaktuar në pikën 14 të Vendimit të Komisionerit, njësia përgjegjëse ka vendosur:

1. Për punonjësën ***** me detyrë “*Inspektore për Mbrojtjen e Fëmijëve*” në Njësinë Administrative Sukth, me aktin nr.22, dt.29.02.2016, është bërë lirimi nga detyra, për shkak se fillimi i marrëdhënies së punës është bërë në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. Pas përfundimit të procedurës së parashikuar në nenin 22 të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, me aktin nr.4646, dt.03.06.2016, punonjësja është emëruar “*Nëpunëse civile në periudhë prove*”, në pozicionin “*Inspektore për Mbrojtjen e Fëmijëve*”.
2. Për nëpunësen ***** me detyrë “*Inspektore për Mbrojtjen e Fëmijëve*”, shkak për ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit me aktin administrativ nr. 7684, dt.18.09.2015, është bërë shkurtimi i pozicionit të punës, pas miratimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr.281, dt. 9.09.2015, “*Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Durrës*”.

Pavarësisht faktit se janë revokuar dy aktet e cituara më sipër nga ana e njësisë përgjegjëse, përsëri vendimi nuk është zbatuar plotësisht për arsye se nëpunësja Viola Ibrahimimi duhet të kthehej në pozicionin e punës që kishte pasur më parë.

- Pozicioni “*Inspektor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve*”, pranë Njësisë Administrative Sukth, që mbante nëpunësja Viola Ibrahimimi, efektivisht *nuk rezulton të jetë shkurtuar*, pasi është parashikuar përsëri në strukturën e re të institucionit. Emërimi i punonjësës ***** me aktin nr.7320, dt.1.10.2015, është bërë në kundërshtim me ligjin, duke mos respektuar procedurat e konkurrimit. Në përputhje me rekomandimin e Komisionerit, njësia përgjegjëse e Bashkisë Durrës ka bërë revokimin e këtij akti (në përputhje me ligjin nr. 8485, dt. 12.05.1999, “*Kodi i Procedurave Administrative të RSH*”, i cili ishte në fuqi në atë kohë). Mirëpo, përderisa kjo çështje ishte duke u shqyrtuar nga gjykata, njësia përgjegjëse nuk mund ta shpallte këtë pozicion të lirë dhe më pas ta plotësonte përmes procedurës së konkurrimit siç ka vepruar, por duhej të priste përfundimin e procesit gjyqësor. Aktualisht, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka dalë me vendim për këtë çështje, duke u shprehur në favor të nëpunësës ***** , por ky vendim nuk ka marrë formë të prerë për shkak të apelimit të tij.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin nr.24, datë 11.03.2016, “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në Bashkinë Durrës*”, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Bashkisë Durrës janë zbatuar të gjitha rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit nr. 24, datë 11.03.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në Bashkinë Durrës”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit Bashkia Durrës.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Bashkia Durrës dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA